

20151935335

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR EKONOMI TË UJËRAVE

Neni 1

Në Ligjin për ekonomi të ujërave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 51/15), në nenin 42 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse shuma “prej 1.500 deri 3.000 euro” zëvendësohen me shumën “deri 3.000 euro”.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për SHA Ekonomia e ujërave do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në SHA Ekonomia e ujërave për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.”

Neni 2

Në nenin 43 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse fjalët: “prej 1.500 deri 3.000 euro” zëvendësohen me fjalët: “deri 1500 euro”, ndërsa pas fjalëve: “personi juridik – shfrytëzues” shtohen fjalët: “përkatësisht tregtar individ – shfrytëzues”.

Në paragrafin (2) pas fjalëve: “personi juridik” shtohen fjalët: "përkatësisht tregtarit individ".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik përkatësisht për tregtar individ do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.”

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Personit juridik përkatësisht tregtarit individ përveç gjobës nga paragrafi 1 i këtij neni do t’i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e veprimtarisë së veçantë në kohëzgjatje prej tre muaj deri në tre vjet.”

Pas paragrafit (4) shtohet 5 paragrafë të rinj (5), (6), (7), (8) dhe (9) si vijojnë:

“(5) Personit përgjegjës në personin juridik përkatësisht tregtarit individ përveç gjobës nga paragrafi 3 i këtij neni do t’i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e profesionit apo detyrës në kohëzgjatje prej tre deri në 30 ditë.

(6) Ndalesa nga paragrafi 5 i këtij neni mund të zëvendësohet me kompensim me para vetëm nëse kundërvajtja është bërë për herë të parë.

(7) Lartësia e kompensimit me para nga paragrafi 6 i këtij neni arrin shumën e dyfishtë nga shuma e gjobës së matur të përcaktuar në këtë nen.

(8) Kompensimi me para nga paragrafi 7 i këtij neni kryerësi është i detyruar ta paguajë në afat prej tre ditë nga dita kur i është caktuar me akt të organit kompetent.

(9) Nëse kryerësi nuk e paguan kompensimin me para në afat prej tre ditësh, ndalesa nga paragrafi 4 i këtij neni do të realizohet.”

Neni 3

Në nenin 44 fjalët: “prej 500 deri 1.000 euro” zëvendësohen me fjalët: "prej 300 deri 450 euro”.

Neni 4

Pas nenit 45 pas paragrafit (2) shtohen 9 paragrafë të rinj (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10) dhe(11) si vijojnë:

“(3) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj, inspektori i ekonomisë së ujërave mundet kryerësit të kundërvajtjes t’i lëshojë urdhëresë pagesore kundërvajtëse, para se të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(4) Nëse kryerësi e pranon urdhëresën pagesore kundërvajtëse, të njëjtën duhet ta nënshkruaj. Pranimi i urdhëresës pagesore kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

(5) Në procesverbalin përcaktohet mënyra në të cilën do të hiqen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e bërë.

(6) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhëresën pagesore kundërvajtëse e nënshkruan personi zyrtar, përkatësisht personi përgjegjës i cili është hasur aty për aty gjatë mbikëqyrjes inspektuese apo person tjetër zyrtar apo person përgjegjës i cili ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruaj procesverbalin dhe ta pranojë urdhëresën pagesore kundërvajtëse.

(7) Deklarata nga paragrafi (6) i këtij neni shënohet në procesverbal.

(8) Inspektori është i detyruar të mbajë evidencë për urdhëresat pagesore kundërvajtëse të lëshuara dhe për rezultatin e tyre.

(9) Në evidencën nga paragrafi (8) i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhëresës pagesore mandatare/kundërvajtëse që i jepet dhe rezultati i procedurës.

(10) Të dhënat personale nga paragrafi (9) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën.

(11) Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhëresës pagesore kundërvajtëse.”

Neni 5

Pas nenit 46 shtohet neni i ri 46-a si vijon:

“Neni 46-a

Matja e lartësisë së gjobave për personin juridik përkatësisht tregtarit individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”

Neni 6

Akti nënligjor i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.